



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

të mbledhjes së nëntë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, e mbajtur më 12.11.2015, e cila filloi në orën 10:00.

Në mbledhje morën pjesë: Halim Halimi, kryesues i Kuvendit, Shpend Ahmeti, Kryetar i Komunës, këshilltarët e Kuvendit: Sami Hamiti, shef i GP-së (LDK), Hazir Borovci (LDK), Agim Gashi (LDK), Shefki Gashi (LDK), Sokol Krasniqi (LDK), Shaip Hajrizi (LDK), Muhamet Nura (LDK), Naime Osmani (LDK), Vlora Dumoshi (LDK), Besa Rafuna (LDK), Ajnishahe Azemi (LDK), Hasime Krasniqi (LDK), Merita Surkishi (LDK), Flamur Shala (LDK), Abit Kastrati (LDK), Shiqeri Spahiu (LDK), Sylejman Pireva (LVV), Genc Sherifi (LVV), Teuta Krasniqi (LVV), Bardha Dida – Rogova (LVV), Hatixhe Hoxha (LVV), Hatixhe Latifi – Pupovci (LVV), Qëndron Kastrati, shef i GP-së (LVV), Ylli Hoxha (LVV), Kreshnik Ahmeti (LVV), Sadri Ramabaja (LVV), Lirak Çelaj, shef i GP-së (PDK), Shemsi Veseli (PDK), Lirie Avdiu (PDK), Lirijeta Rexhepi (PDK), Muhamet Selmani (PDK), Laura Zherka (PDK), Shaip Shabani (PDK), Islam Pacolli, shef i GP-së (AKR), Mirlinda Sopi (AKR), Sofije Bunjaku (AKR), Imer Rusinovci, shef i GP-së (AAK-LDD), Rita Begolli (AAK-LDD), Fadil Gashi (AAK-LDD), Brahim Mehmetaj, shef i GP-së (LB), Abetare Fazliu (LB), Feti Mehdiu, shef i GP-së (PD), Kimet Zeqa (PD), Visar Arifaj, përfaqësues i subjektit politik (PF), Nenad Miladinoviqi, përfaqësues i subjektit politik (GIS) dhe Cuneyd Ustaibo, përfaqësues i subjektit politik (KDTP).

Munguan: Vjollca Dibra - Ibrahim (LDK), Blerand Stavileci (PDK) dhe Remzi Pacolli (AKR).
Të pranishëm ishin edhe drejtorët e drejtorive të Komunës, përfaqësues të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, përfaqësues të OJQ-ve, përfaqësues të mediave të shkruara dhe elektronike, përfaqësues të KFOR-it dhe përfaqësues të OSBE-së.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Halim Halimi**, kryesues, i cili ngriti çështjen e radhitjes së pikave të rendit të ditës, duke thënë se ky rend dite nuk është propozuar nga unë si kryesues i Kuvendit, andaj kërkoj që pikat 16, 17 dhe 18 të rendit të ditës, të jenë pikat 3, 4 dhe 5 në rend dite.

Lirak Çelaj u shpreh se, përderisa nuk është sjellë me shkrim vendimi për organizimin e drejtorive, ne nuk do t'i trajtojmë këto pika që kanë të bëjnë me urbanizëm dhe janë në këtë rend dite.

Sami Hamiti theksoi se është dashtë që ne të njoftohemi me shkrim për ndërhyrjet që i ka bërë dikush në ndërkohë në rendin e ditës. Sa u përket pikave të cilat ndërlidhen me urbanizmin, ekziston një qëndrim politik që, derisa të kalojnë në drejtorinë tjetër, mos të trajtohet asnjë pikë që ka të bëjë me drejtorinë përkatëse.

Qëndron Kastrati u shpreh se rendi i ditës përpilohet në bashkëpunim mes kryesuesit dhe Kryetarit të Komunës, andaj ne e kemi një rend të ditës, në të cilin ne duhet të bazohemi. Pra, është çështje e Kuvendit, çështje e shumicës se si vendos, andaj mos të krijohet hamendje. Jemi për këtë rend dite dhe për pikat e urbanizmit, nëse dikush nuk do, atëherë le të urdhërojë le të bëjë çka të dojë.

Për rendin e ditës diskutuan edhe Islam Pacolli, Imer Rusinovci, Feti Mehdiu, Brahim Mehmetaj, Visar Arifaj, Ylli Hoxha, Muhamet Selmani, Shefki Gashi, Cuneyd Ustaibo dhe Nenad Miladinoviqi , diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Lidhur me vërejtjet dhe sugjerimet e dhëna nga parafolësit, Shpend Ahmet, Kryetari i Komunës, dha sqarime të nevojshme, diskutimi i të cilit është dhënë i plotë në transkript.

Para se të hedhet në votim rendi i ditës, kryesuesi kërkoi nga z. Muhamet Nura, që ta bëjë betimin si anëtar i ri i Kuvendit.

Kryesuesi e hodhi në votim rendin e ditës (ashtu si është prezantuar për mbledhje).

Kryesuesi konstatoi se me njëzet e dy (22) vota për dhe me njëzet e katër (24) vota kundër (Halim Halimi, Hazir Borovci, Sami Hamiti, Vlora Dumoshi, Agim Gashi, Shefki Gashi Mustafë Krasniqi, Shaip Hajrizi, Abit Kastrati, Sokol Krasniqi, Muhamet Nura, Naime Osmani, Ajnishahe Azemi, Hasime Krasniqi, Merita Surkishi, Flamur Shala, Shiqeri Spahiu, Besa Rafuna, Shaip Shabani, Muhamet Selmani, Lirie Avdiu, Laura Zherka, Lirijeta Rexhepi dhe Shemsi Veseli), nuk u miratua rendi i ditës ashtu siç ishte prezantuar për mbledhje.

Kryesuesi tha se ishte propozim i GP-ve të PDK-së dhe LDK-së, që të hiqen nga rendi i ditës pikat që kanë të bëjnë me Drejtorinë e Urbanizmit. Këtë propozim kryesuesi e hodhi në votim.

Kryesuesi konstatoi se, me njëzet e pesë (25) vota për dhe njëzet e një (21) vota kundër (Hatixhe Hoxha, Qëndron Kastrati, Ylli Hoxha, Hatixhe Latifi - Pupovci, Teuta Krasniqi, Genc Sherifi, Sylejman Pireva, Sadri Ramabaja, Kreshnik Ahmeti, Bardha Dida - Rogova, Rita Begolli, Imer Rusinovci, Fadil Gashi, Brahim Mehmetaj, Abetare Fazliu, Feti Mehdiu, Kimet Zeqa, Visar Arifaj, Nenad Miladinoviqi dhe Cuneyd Ustaibo) hiqen nga rendi i ditës pikat që kanë të bëjnë me Drejtorinë e Urbanizmit.

Kryesuesi konstatoi se u miratua ky

REND I DITËS:

1. Miratimin e ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së tetë të Kuvendit;
2. Betimi i anëtarit të ri të Kuvendit;
3. Rikategorizimi i parkut regjional natyror "Gërmia" në kategorinë - Peizazh i mbrojtur "Gërmia";
4. Propozimrregullorja për organizimin e punës në shkolla fillore, të mesme të ulëta dhe të mesme të larta;
5. Caktimi i Komisionit për përzgjedhjen e kryetarëve të Bashkësive lokale;
6. Propozimvendimi për formimin e grupit punues për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores për bashkësi lokale;
7. Raporti buxhetor për situatën ekonomiko - financiare të Komunës për periudhën janar - qershor 2015;
8. Raporti buxhetor tremujor, korrik - shtator 2015;
9. Raporti i auditimit për pasqyrat financiare të Komunës së Prishtinës për vitin e Përfunduar, më 31 dhjetor 2014;
10. Propozimvendimi për dhënien në shfrytëzim pa pagesë të hapësirave SHML "Gjimanzi Matematikor" për Institutin ndërkombëtar për inteligjencë të jashtëzakonshme "Atomi";
11. Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për kishën dhe varrezat protestante;
12. Pyetje dhe përgjigje;
13. Të ndryshme.

Para se të fillonin me diskutimet rreth pikave të rendit të ditës, GP i LVV-së, GP i AAK-se, GP i PD-së, GP i AKR-së, GP i LB-së, përfaqësuesi i subjektit politik GIS dhe përfaqësuesi i subjektit politik KDTP e lëshuan mbledhjen.

Kryesuesi konstatoi se, në mungesë të kuorumit, mbledhja ndërpritet dhe nuk mund të vazhdojë.

Mbledhja u ndërpre ne orën 11:45.

Procesmbajtësi
Zijadin Gashi

Kryesuesi i Kuvendit
Halim Halimi, jur. i dipl.

Faqe 4 nga 4
